



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 13, datë 30.12.2021

**PËR**  
**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “OBJEKT PËR SHËRBIME**  
**TREGTARE DHE MAGAZINIM”, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË VORË**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Tirana Business Park” sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Objekt për shërbime tregtare dhe magazinim”, me vendndodhje në Bashkinë Vorë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Tirana Business Park” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
  - a) miratimit të akteve përkatëse sipas legjislacionit të posaçëm për trashëgiminë kulturore;
  - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Vorë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

